



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 842 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3170/1, DATË 23.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. VIOLETA LELÇAJ”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura të znj. Violeta Lelçaj me nr. 2040 prot., datë 13.04.2021 dhe 2040/2 prot., datë 14.04.2021, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjstrates B.H, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në kohën e kryerjes së shkëljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3170/1 prot., datë 23.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Violeta Lelçaj”, bazuar në nenin 121, pika 2 shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lezhë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Lagjja “Besëlidhja”, Lezhë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Konceptoi: Z. Feçi  
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi  
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024

